



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Ekstrakt**

**nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me banorët dhe përfaqësuesit e fshatrave të rajonit të Kërpimëhut, mbajtur më 12 qershor 2018**

Takimi filloi në orën 17:00, dhe u mbajt në SHFMU "Hamit Sejdiu" në fshatin Kërpimëhut. Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave. Pjesëmarrës nga Ekzekutivi i Komunës ishin z.Vezir Januzi drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Gëzim Namani drejtor i Drejtorisë së Administratës. Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

**Çështja: Dëgjim buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2019/01**

**Isuf Latifi**, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, dhe shtoi, si Komunë jemi në proces të hartimit të buxhetit të Komunës për vitin 2019 dhe prioritetet për vitet 2020 – 2021, proces ky i cili natyrisht se duhet t'i nënshtrohet edhe konsultimeve me publikun me qëllim që të jemi sa më afër qytetarëve, marrjes së propozimeve nga ana e tyre si dhe paraqitja e kërkesave dhe nevojave të ndryshme që kanë. Pra arsyeja e thirrjes së këtij takimi është që Komuna të njihet përsëafërmi me kërkesat, propozimet dhe nevojat e banorëve dhe përfaqësuesve të fshatrave të rajonit të Kërpimëhut.

**Vezir Januzi**, drejtor i DBPZHR, përshëndeti të pranishmit dhe falënderoj për pjesëmarrjen e tyre në takim, ndër të tjera theksoi, t'ju them të drejtën unë kam pritur një numër më të madh të banorëve të kësaj ane. Ne vazhdimisht kemi takime me banorë përfaqësues të fshatrave të këtij rajoni. Shumica e projekteve infrastrukturore pothuajse janë përfunduar në këtë rajon, mirëpo natyrisht ka edhe kërkesa dhe nevoja të tjera nga ana e banorëve të fshatrave dhe lagjeve të ndryshme, prandaj mos hezitoni t'i paraqitni konkretisht kërkesat dhe nevojat e juaja prioritare në mënyrë që të njëjtat të shqyrtohen pastaj dhe varësisht mundësive buxhetore të përfshihen në buxhet. Fjala për ju.

**Ramadan Zymeri**, përfaqësues i fshatit Metehi, theksoi, fillimisht ju njoftoj se përveç përfaqësuesit të fshatit Metehi, jam edhe në cilësinë përfaqësuesit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës për shkak se mungon drejtori z.Faik Muçiqi, ku do të marrë propozimet, kërkesat dhe nevojat e paraqitura nga Ju, që kanë të bëjnë me këtë Drejtori.

Fshati Metehi falënderon Komunën e Podujevës për investime të shumta në fusha të ndryshme, mirëpo edhe përkundër investimeve të shumta kemi edhe disa kërkesa për përfshirje në buxhetin e Komunës, dhe atë;

- asfaltimi i disa rrugicave të fshatit (të cilat do t'i paraqesim në formë të shkruar)
- vazhdimi i rregullimit të kanalizimit dhe përmbyllja e këtij projekti.
- rregullimi i hapësirave në afërsi të shkollës së fshatit

-asfaltimi i rrugës që lidh fshatrat Metehi – Dobërdol – Kërpimeh.

-ndërtimi i pendës dhe sistemit të ujitjes.

**Sinan Behrami**, - nga fshati Metehi, fillimisht shtroi pyetje rreth rr. "Guri" rrugës në drejtim të Lagjes Behrami në gjatësi rreth 820 m, përse nuk është asfaltuar edhe pse ka qenë në prioritet dhe për të njëjtën kërkoj të përfshihet në buxhetin e vitit 2019 sepse siç tha rruga është në gjendje shumë të keqe edhe përkundër që është intervenuar disa herë me zhavorr.

**Muhamet Kameri**, - nga fshati Metehi, po ashtu paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës në Lagjen Behrami në fshatin Metehi si dhe disa rrugë dhe rrugica tjera të fshatit.

**Isuf Gashi**, përfaqësues i fshatit Dobërdol, paraqiti kërkesat si në vijim:

-asfaltimi i rrugës që lidh fshatrat Metehi – Dobërdol – Kërpimeh,

-asfaltimi i rrugës Dobërdol – Llaushë

-asfaltimi i rrugës Dobërdol – Bajqinë

-asfaltimi i rrugicave të fshatit; rr. "Vëllëzrit Gashi" 500 m, rr. "Sali Gashi" 120 m, rr. "Bedri Gashi" afër 700 m, dhe ajo e Lagjes Selmani.

-intervenimi me zhavorr i pothuajse të gjitha rrugëve të paasfaltuara duke filluar nga varrezat në drejtim të Përpellacve deri tek Prroni, pastaj nga Lagja Hajrovit deri tek Konaku, nga Prroni i Zekës deri tek Baltaku, mandej nga rr. "Haki Regjep Gashi" deri te rr. "Mrrizi i Prehjes".

-ndërtimi i kanalizimit nga Lagja Thaqi deri tek lumi Llap përkatësisht rr. "Xhevahir Gashi", rr. "Avdullah Gashi" si dhe nga Lagja Asllani deri tek Lagja Bekovit.

**Naim Hoxha**, përfaqësues i fshatit Pakashticë, paraqiti kërkesat si në vijim:

-vendosja e tabelave të rrugëve

-rruga Pakashticë – Revuçë,

-vazhdimi i ndërtimit të kanalizimit dhe përfundimi i këtij projekti

-intervenimi me zhavorr në rrugën e Lagjes Parduzi

-ndërtimi i trotuarit nga Shkolla e fshatit në drejtim të fshatit.

**Mustaf Mustafa**, drejtor i shkollës në fshatin Metehi, paraqiti kërkesat si në vijim:

-ndërtimi i objektit të ri të shkollës,

-ndërtimi i trotuarit në rrugët kryesore të fshatit Metehi.

**Hilmi Salihu**, përfaqësues i fshatit Revuç, paraqiti kërkesat si në vijim;

-asfaltimi i rrugës tek varrezat, rreth 700 m

-asfaltimi i rrugës tek Lagja Maksuti

-asfaltimi i rrugicës tek lagja – shtëpia e Xhafer Hotit

-asfaltimi i rr. "Xhavit Nimani"

-asfaltimi i rrugicës tek Lagja Merovci

-asfaltimi i rr. "Halil Bekteshi"

-Po ashtu paraqesim kërkesën e përbashkët të fshatrave të ish bashkësisë lokale të Kërpimehut, për ndriçim të fshatrave, me theks fshatrat Kërpimeh, Dobërdol, Metehi.

-ndërtimi i trotuarit nga Kërpimehu në Revuç duke përfshirë edhe Lagjen Januzovit

**Ramadan Azizi**, përfaqësues i fshatit Repë, paraqiti kërkesat si në vijim;

-ndërtimi i një Ure, për të cilën theksoi se është e nevojshme për një familje, por edhe duke u nis nga fakti se viteve të fundit janë ndërtuar 5 ura kurse ka mbetur vetëm 1 pa ndërtuar.

-asfaltimi i rrugës rreth 200 – 400 m, në pjesën e poshtme të fshatit përfshirë edhe kanalizimin, për të cilën është hartuar projekti.

-rruga në drejtim të Lagjes Rrustemi, rreth 1000 m.

**Isuf Jashari**, përfaqësues i fshatit Breçë, paraqiti kërkesat, si vijon:

-vendosjen e tabelave, me theks në rrugën që kalon për urë

-asfaltimi i rr. "Isa Jashari" .

**Qefser Behrami**, - drejtor i Shkollës së Kërpimehut, paraqiti kërkesat si në vijim:

-renovimi i shkollës me dyer dhe dritare të reja

-sigurimi i ujit të pijes në shkollë

-ndërtimi i fushës sportive në paralelen e shkollës në fshatin Pakashticë, dhe shtoi, si dhe mbrapa asaj shkolle është një objekt - aneksi i vjetër i cili paraqet rrezik për objektin e shkollës andaj edhe kërkohet të intervenohet në me rrënim ose rinovim. Po ashtu gjatë punimeve në një projekt të kanalizimit në fshatin Pakashticë, punëkryesi nuk ka sanuar dëmet e shkaktuara në rrethojat e shkollës gjë e cila paraqet rrezik për nxënësit, andaj kërkohet të ndërmerret diçka nga Komuna përkatësisht mbikëqyrësit e atij projekti.

-zgjidhja e problemit të objektit të vjetër të shkollës së fshatit Kërpimeh, për shkak siç tha, paraqet rrezik për nxënësit dhe mundësi për dukuri negative eventuale.

-Gjithashtu është kërkesë e fshatrave të këtij rajoni që të ndërmerren masa ndaj prerësve ilegal të pyjeve në këtë rajon ngase konsiderojmë se përveç prerjeve ilegale po dëmtohen edhe pyjet qoftë ato publike qoftë private.

**Merxhan Ademi**, - nga fshati Metehi, paraqiti kërkesën për asfaltimin e 3 rrugicave afërsisht 180 m, në Lagjen Ademi në fshatin Metehi.

**Afrim Fejzullahu**, përfaqësues i fshatit Reçicë, paraqiti kërkesat si në vijim:

-intervenim – riparim i rrugës rreth 5 km, duke filluar nga Përmendorja, ngase siç tha, nga reshjet është dëmtuar shumë.

-kërkesë për ndërmarrjen e masave për sjelljen e rrjetit të telefonisë mobile, Vala ose Ipko.

**Behar Latifi**, përfaqësues i fshatit Sllatinë, paraqiti kërkesën për intervenim në rrugën e cekur nga parafolësi, përkatësisht nga Përmendorja e Reçicës në drejtim të fshatit Sllatinë.

**Vezir Januzi**, drejtor i DBPZHR, theksoi, deri tani dëgjuam vetëm kërkesa për infrastrukturë, në fakt Komuna e Podujevës ka investuar shumë në rregullimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së fshatrave dhe vazhdon të investoj sipas nevojave, mirëpo unë presë edhe kërkesa, ide, propozime dhe iniciativa të ndryshme në fusha të ndryshme për investime qoftë në bujqësi e të ngjashme.

**Sinan Behrami**, paraqiti kërkesën për shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrik.

**Isuf Gashi**, në emër të përfaqësuesve të fshatrave të ish Bashkësisë Lokale të Kërpimehut, paraqiti kërkesën për gjetje e mundësive për zgjidhjen e problemit të ujit të pijes për këtë pjesë të rajonit të Llapit duke theksuar se është e domosdoshme ndërtimi dhe shtrirja e ujësjellësit për këto fshatra. Si mundësi përmend një iniciativë të ndërmarrë në bashkëpunim me Komunën, fjala është për një projekt të tillë në Fshatin Çenog.

**Vezir Januzi**, drejtor i DBPZHR, dha disa sqarime parafolësit rreth mundësive për ndërtimin dhe shtrirjen e ujësjellësit për fshatrat e kësaj ane. Njëkohësisht ftoj përfaqësuesit e fshatrave për një takim të përbashkët rreth kësaj çështjeje, duke shpresuar në një zgjidhje sa më të shpejtë rreth shtrirjes dhe furnizimit me ujë të pijes.

**Takimi përfundoi në orën 18:05**

**Procesverbalin e mbajtën:**

**Sabedin Namani**

**Enis Sheholli**

**Podujevë,  
12 qershor 2018**

**Drejtori i DBF  
Isuf latifi**